



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***02 - 03 Dhjetor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Ipçja: Spitali i ri i Kërçovës, gati në vitin 2017

**Shkup, 2 dhjetor** - Një delegacion i Bashkimi Demokratik për Integrim, i udhëhequr nga Sekretari shtetëror i Ministrisë së Shëndetësisë, Nasuf Ipçja, sot vizitoi Spitalin e Kërçovës, ku u njoh me procesin e punës së këtij spitali dhe zhvillimin e tij në planin infrastrukturor, kadrovik dhe organizativ.

“Si rezultat i nevojave të qytetarëve të Kërçovës, ne kemi një plan të përbashkët në realizim e sipër, për ndërtimin e Spitalit të ri të qytetit, i cili presim që deri në vitin 2017, të jetë gati për shërbime ndaj pacientëve. Përpos ndërtimit të kësaj godine të re shëndetësore, ne kemi një plan për investime edhe në infrastrukturë, në aparate medicinale, si dhe në punësime të personelit shëndetësor dhe ndihmës në Spitalin e qytetit dhe në Shtëpinë e Shëndetit të Kërçovës”, theksoi sekretari Ipçja.

Drejtorët e këtyre dy institucioneve shëndetësore në Kërçovë, e përshëndetën vizitën dhe interesimin e zyrtarëve të BDI-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për krijimin e kushteve më të mira për punë dhe shërbime më cilësore ndaj pacientëve.

## PLD: Urgjentisht të legalizohet kanabisi në Republikën e Maqedonisë

**Shkup, 2 dhjetor**- Partia Liberal Demokratike kërkon që urgjentisht të legalizohet kanabisi në Republikën e Maqedonisë. Sipas kësaj partie, duhet që të ndërpriten debatet në këtë temë dhe urgjentisht të ndërmerret hap drejt legalizimit, transmeton [zhurnal.mk](http://zhurnal.mk)

“Partia Liberal Demokratike vlerëson se legalizimi i kanabisit për qëllime mjekësore duhet që të jetë realiteti i jonë edhe atë shumë shpejtë.

Pjesa më e madhe e njerëzve janë të sëmurë nga lloje të ndryshme të sëmundjeve dhe po e shfrytëzojnë vajin nga kanabis si bar. Nuk guxojmë që njerëzit me probleme shëndetësore serioze të i shndërrojmë në kriminel.

Përderisa kanabisi është jo legal, barnat që dalin prej tij nuk do të janë të standardizuara, ndërsa fati i të sëmurëve të caktuar do të ngel në duart e dilerëve të ndryshëm.

Mjaft ishin debate dhe tryeza të rumbullakëta në temën nëse kanabisi shëron ose jo. Në vend që të debatohet, duhet parë gjendja faktike. Në korniza botërore ka shkencëtar dhe mjek të cilët pesëdhjetë vite po hulumtojnë në këtë temë dhe kanë dëshmi empirike për veprimet shëruese të kanabisit. Jo rastësisht



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



legalizimi i kanabisit është realitet në shtetet më të zhvilluara të botës”, thuhet në reagimin e PLD-së, transmeton zhurnal.mk

## Konferencë kundër dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara

**Shkup, 2 dhjetor** - Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare dhe H.E.R.A.-Asociacioni për hulumtim shëndetësor dhe edukim sot organizojnë konferencë në temë “Parandalimi i dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara.

Gjendja në shtet dhe rekomandime”. Konferenca është në kuadër të fushatës “16 ditë aktivizim kundër dhunës ndaj grave” e cila zbatohet çdo vit nga 25 Nëntori – Dita ndërkombëtare për luftën kundër dhunës ndaj grave deri më 10 Dhjetor – Dita ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Është paralajmëruar fjalim i Luiza Vinton, koordinuese e përhershme e KB-së dhe përfaqësuese e UNDP-së dhe UNFPA-së në Republikën e Maqedonisë, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Fakulteti filozofik, si dhe të grave-aktiviste me aftësi të kufizuara dhe aktivistë për përparimin e të drejtave të grave dhe personave me aftësi të kufizuara.

## Debat i hapur në Tetovë me temë 'Mjedisi i pastër si e drejtë themelore e njeriut'

**Shkup, 2 dhjetor** - Diskutimi do të zhvillohet të enjten më 3 dhjetor, nga ora 12.00 në sallën e këshillit të Komunës së Tetovës. Diskutimi zhvillohet në kuadër të projektit Diskutime Glokale. Panelistë për këtë temë do të jenë Arianit Xhaferi, lider i Eko Gerilla dhe Teuta Xhaferi sekretare e Komunës së Tetovës.

Diskutimi është i hapur për publikun. Qëllim i këtij diskutimi, si edhe i 11 të tjerave është që të nxisë debat, por edhe të përforcojë qeverisjen e mirë, duke i dhënë zë të gjithëve të shprehen për tema që janë të rëndësishme për gjithë shoqërinë.

## Autistët sot flasin në Shkup

**Shkup, 2 dhjetor** - Tryezë e rrumbullakët me temën "Fëmijët me autizëm në arsimin e rregullt fillor", do të mbahet sot në BE Info Qendrën në Shkup.

Tryezën e rrumbullakët do ta hapin avokati i popullit Ixhet Memeti, menaxherja e programit për arsim dhe barazi gjinore nga Deleacioni i Bashkimit Evropian në Shkup, Sofi Boman dhe ambasadorja e Austrisë në Maqedoni, Renate Kobler.

Hulumtimi i zbatuar nga Zyra e Avokatit të Popullit për "Perceptim të gjendjeve me realizimin e të drejtës së arsimit të fëmijëve me çrregullim të spektrit të autizmit në shkollat fillore", do ta prezantojë zëvendësavokatja e popullit, Vaska Bajramovska-Mustafa, ndërsa përvojën e Austrisë për këtë gjendje do ta transmetojë prof.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)




Ernest Berger përfaqësues i Bordit të Ombudsmanit austriak.

Për "Aktivitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për zhvillim të arsimit në raport të arsimit të fëmijëve me autizëm", do të flasë Snezhana Tërpevska - këshilltare për edukim dhe arsimim të fëmijëve me nevoja të veçanta, derisa me temën Sfidat e procesit inkluziv në SHF "Gjorgjija Pulevski"-Shkup do të flasë Elizabeta Petroviq, mësimdhënëse dhe trajnuese kombëtare për inkluzion.

Tryeza e rumbullakët mbahet në suaza të Tuining projektit të quajtur si "Promovimi i kompetencave të Avokatit të Popullit dhe përforsimi i kapaciteteve institucionale", ndërsa të cilin e zbaton Avokati i popullit në bashkëpunim me Zyrën e Bordit të Ombudsmanit austriak dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut, Ludvig Boltzman.

## Ndotje e ajrit në Shkup, Tetovë, Kërçovë dhe Koçan



**Shkup, 2 dhjetor** - Në rajonin e Shkupit, Tetovë, Manastir, Kërçovë dhe Koçan sot në mëngjes janë regjistruar koncentrimet të larta të grimcave PM10, të cilat lëvizin prej 100 deri 300 mikrogramë në metër kub...

Në stacionin matës në Tetovë në orën nëntë sot në mëngjes janë matur 516 mikrogramë, ndërsa gjatë natës niveli maksimal arriti 833. Nga komunat e Shkupit më e ndotura ishte Qendra me 296 mikrogramë, pasojnë Karposhi me 282, Gazi Baba me 194, Lisiçe 172, ndërsa tek Rektorati janë matur 150 mikrogramë në metër kub.

Në Kërçovë janë regjistruar 142 mikrogramë, në Koçan 101 dhe në Kavadar 68 mikrogramë në metër kub.



## Shënohet Dita ndërkombëtare e personave me invaliditet



Në organizim të Këshillit kombëtar të organizatave invalidore të Maqedonisë sot në Shkup do të shënohet 3 dhjetori - Dita ndërkombëtare e personave me invaliditet...



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Në kuadër të shënimit do të mbahet tribunë në temë "Inkluzioni është i rëndësishëm: Qasje dhe përforsim i të gjitha aftësive të çdo personi me invaliditet".

Është paralajmëruar fjalim i ministres së Punës dhe Politikës Sociale Frosina Tashevaska-Remenski dhe të kryetarit të KKOIM, Çedomir Trajkovski.

Në këtë organizim të shënimit të Ditës ndërkombëtare të personave me invaliditet janë përfshirë edhe Lidhja kombëtare e personave të verbër të RM-së, Lidhja kombëtare e personave të shurdhër dhe personave me vështirësi në dëgjim të RM-së, Lidhja kombëtare e personave me invaliditet trupor të Maqedonisë - Mobilitet Maqedonia, Qendra republikane për mbështetje të personave me aftësisë së kufizuar intelektuale - Porosi, Lidhja kombëtare e invalidëve civil nga lufta e Maqedonisë, Federata kombëtare për sport dhe rekreacion të invalidëve - Komiteti paraolimpik i Maqedonisë dhe Lidhja kombëtare e invalidëve të punës së RM-së. (mia.mk)

## Gratë me aftësi të kufizuara-viktima të dhunës, mungon përkrahje dhe mbrojtje nga institucionet

Dhuna fizike, psikike, ekonomike janë format më të përhapura të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, e sidomos ndaj grave të kësaj kategorie...



Madje, kjo dhunë shkon deri aty sa ata përballen edhe me shtyrjen e karrocave të tyre të invalidit, si shenjë përbuzje. Por, për këtë dhunë shoqëria jonë nuk flet shumë. Gratë me aftësi të kufizuara marginalizohen madje edhe nga institucionet, por ato nuk e denoncojnë dhunën.

*"Ata mund të jenë viktima të dhunës fizike, psikike, ekonomike nga anëtarët e tjerë të familjes ose të personave që kujdesën për ta. Në të shumtën e rasteve ndodhë t'u refuzohet shërbimi shëndetësor, madje ka raste*

*të shumta kur ndaj grave me aftësi të kufizuara përdoret dhunë"*- tha Vesna Matevska nga "Hera".

*"Nëse tek një grua me aftësi të kufizuara, veçanërisht me pengesa fizike, paraqet dhunë, asaj i duhet mbrojtje, por shteti nuk ua siguron, madje, për fat të keq, këtë nuk ua sigurojnë as organizatat joqeveritare, sepse shërbimet tona nuk janë të arritshme për këtë kategori"*- theksoi Elena Dimushevska nga Rrjeti Kombëtar kundër dhunës ndaj gruas me aftësi të kufizuara.

Koordinatorja e Kombeve të Bashkuara në Maqedoni, Luiza Vinton, thotë se duhet ngritur vetëdija qytetare dhe institucionale që do t'u ndihmonte personave, e sidomos grave me aftësi të kufizuara, të mos bëhen viktima të dhunës.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



**“80 për qind e grave me ndonjë lloj të aftësisë së kufizuar përballen me dhunë ose keqpërdorim. Kjo sepse predispozohet se ato nuk janë të afta të mbrohen. Kjo kategori jo vetëm që duhet të trajtohen si viktimat e të mbrohen nga shteti, por duhet të kenë mundësi të përfaqësohen, kjo është mënyra e duhur”**- tha koordinatori e KB-së në Maqedoni, Luiza Vinton.

Sipas statistikave botërore, personat me aftësi të kufizuara janë tre herë më shumë viktimat e dhunës se të tjerët, pikërisht për shkak të paaftësisë për t'u mbrojtur. Por, Maqedonia nuk ka të dhëna të sakta për numrin e viktimave të personave me aftësi të kufizuara.

## Fëmijët me autizëm, mungojnë defektologët krahas problemeve të tjera



**Në Maqedoni, fëmijët me autizëm ballafaqohen me probleme të mëdha, mungojnë trajnimet në kuadrin mësimdhënës për punë me këta fëmijë...**

Në Maqedoni, fëmijët me autizëm ballafaqohen me probleme të mëdha, mungojnë trajnimet në kuadrin mësimdhënës për punë me këta fëmijë, mungon sensibilizimi i plotë i kuadrin mësimdhënës, ka mësimdhënës të cilët refuzojnë të punojnë dhe konsiderojnë se fëmijët me autizëm nuk duhet të jenë pjesë e arsimit të rregullt fillor, por duhet të regjistrohen në paralele ose në shkolla fillore të veçanta. Vërehet edhe

diskriminim nga prindërit e moshatarëve të tyre.

Zyra e Avokatit të Popullit ka hulumtuar 256 shkolla në vend dhe ka konstatuar se megjithëse fëmijët me autizëm përfshihen në arsimin e rregullt fillor, jo të gjitha shkollat janë të përgatitura që atyre t'u sigurojnë arsimin përkatës, në përputhje me nevojat e tyre.

**“Hulumtimi ynë tregon se Republika e Maqedonisë ka bërë mjaft në aspekte të rregullimit formal të legjisllacionit dhe të pranimeve të konventave, por në anën tjetër, sa i përket krijimit të kushteve, si kushteve hapësinore nëpër shkolla, si kushteve kadrovike me personel përkatës apo profesional, jo vetëm të arsimit, por edhe të sferës së shëndetësisë, nuk ka krijuar kushte të mjaftueshme që këta fëmijë të mund bashkë me moshanikët e tyre të futen në arsim fillor”**- deklaroi avokati i popullit, Ixhet Memeti.

Nga Instituti për Defektologji thonë se gjendja me defektologët është alarmante. Në çdo shkollë duhet të ketë nga një defektolog, që të punojë çdo ditë me fëmijët me autizëm, por kjo nuk respektohet në praktikë.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



**“20% e fëmijëve me autizëm kanë inteligjencë normale, 5% kanë inteligjencë mbi mesatare, ndërsa 75% kanë inteligjencë mjaft të ulët dhe këta të fundit e kanë shumë më të vështirë të përfshihen në shkollë. Në çdo shkollë fillore duhet të ketë nga një defektolog, nëse duam që te sjellim inkluzionin ashtu sikur në vendet e BE-së”**- theksoi Vladimir Trajkovski nga Instituti për Defektologji.

Avokati i Popullit konstaton se në 67 shkolla fillore numri i fëmijëve me autizëm në arsimin e rregullt fillor lëviz nga 1-17 nxënës. Në një pjesë të shkollave fillore, prindërit e këtyre fëmijëve me shpenzime vetjake sigurojnë defektologë për punë me fëmijët e tyre, ndërkohë që ka raste kur edhe vet prindërit i shoqërojnë fëmijët gjatë orëve të mësimin, përkatësisht gjatë procesit mësimor.

## Tryezë e rrumbullakët për fëmijët me autizëm në arsimin fillor



**Tryezë e rrumbullakët me temën "Fëmijët me autizëm në arsimin e rregullt fillor", do të mbahet sot në BE Info Qendrën në Shkup....**

Tryezën e rrumbullakët do ta hapin avokati i popullit Ixhet Memeti, menaxherja e programit për arsim dhe barazi gjinore nga Deleacioni i Bashkimit Evropian në Shkup, Sofi Boman dhe ambasadorja e Austrisë në Maqedoni, Renate Kobler.

Hulumtimi i zbatuar nga Zyra e Avokatit të Popullit për "Perceptim të gjendjeve me realizimin e të drejtës së arsimit të fëmijëve me çrregullim të spektrit të autizmit në shkollat fillore", do ta prezantojë zëvendësavokatja e popullit, Vaska Bajramovska-Mustafa, ndërsa përvojën e Austrisë për këtë gjendje do ta transmetojë prof. Ernest Berger përfaqësues i Bordit të Ombudsmanit austriak.

Për "Aktivitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për zhvillim të arsimit në raport të arsimimit të fëmijëve me autizëm", do të flasë Snezhana Tërpevska - këshilltare për edukim dhe arsimim të fëmijëve me nevoja të veçanta, derisa me temën Sfidat e procesit inkluziv në SHF "Gjorgjija Pulevski"-Shkup do të flasë Elizabeta Petroviq, mësimdhënëse dhe trajnuese kombëtare për inkluzion.

Tryeza e rrumbullakët mbahet në suaza të Tuining projektit të quajtur si "Promovimi i kompetencave të Avokatit të Popullit dhe përforsimi i kapaciteteve institucionale", ndërsa të cilin e zbaton Avokati i popullit në bashkëpunim me Zyrën e Bordit të Ombudsmanit austriak dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut, Ludvig Boltzman.




FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Konferencë kundër dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara



Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare dhe H.E.R.A.- Asociacioni për hulumtim shëndetësor dhe edukim sot organizojnë konferencë në temë "Parandalimi i dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara. Gjendja në shtet dhe rekomandime"...

Konferenca është në kuadër të fushatës "16 ditë aktivizim kundër dhunës ndaj grave" e cila zbatohet çdo vit nga 25 Nëntori - Dita ndërkombëtare për luftën kundër dhunës ndaj grave deri më 10 Dhjetor - Dita ndërkombëtare për të drejtat e

njeriut.

Është paralajmëruar fjalim i Luiza Vinton, koordinuese e përhershme e KB-së dhe përfaqësuese e UNDP-së dhe UNFPA-së në Republikën e Maqedonisë, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Fakulteti filozofik, si dhe të grave-aktiviste me aftësi të kufizuara dhe aktivistë për përparimin e të drejtave të grave dhe personave me aftësi të kufizuara. (mia.mk)

## Maqedonia për të 16-të herë me rradhë e mbjell të ardhmen e saj



Nën moton "Mbill sukses" sot në më shumë se 100 lokacione në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë do të mbahet aksioni i 16-të "Dita e drurit - mbille të ardhmen tënde", në të cilën do të mbillen tre milionë fidanë në 930 hektarë tokë...

Ashtu siç informojnë nga Shoqata qytetare "Dita e drurit - mbille të ardhmen tënde"! do të mbillen edhe 7.000 lule landra pranë autostradës Gjevgjeli-Smokvicë dhe 3.000 qiparisë pranë autostradave të tjera nëpër vend. Nga Pyjet e Maqedonisë, për të gjitha komunat në

Republikën e Maqedonisë do të ndahen edhe 67.000 fidanë.

Sipas tyre, qytetarët e Maqedonisë deri tani kanë mbjellë rreth 50.000 milionë fidanë druri, ndërsa nga Inspektorati për bujqësi është konfirmuar se janë zënë rreth 60 për qind prej tyre.





FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



Në transport të organizuar nga ora 9 deri në orën 11 qytetarët në të gjitha komunat do të mund t'i vizitojnë lokacionet e caktuara dhe të mbjellin fidanë druri. Kthimi pas është parashikuar në orën 14, informojnë nga Shoqata.

Motoja e aksionit të sivjetëm "Mbill sukses"! është të përkujtohet në motivet, fillimet, fazat zhvillimore dhe rezultatet e aksioneve, të cilat filluanë në pranverë të vitit 2008.

"Gjendja "si ishte" dhe "si është tani" pas 15 aksioneve dhe pas tetë viteve ndiqet edhe përmes idesë dhe porosive të TV-videoklipit "Mbill sukses"!, i cili na përkujton në të gjithë historinë e intervenimit të "Ditës së drurit", ku qytetarët kanë rolin kryesor", theksojnë nga Shoqata.

Fushata ishte përkrahur edhe nga nxënësit e Shkollave të mesme të qytetit të Shkupit, të cilët së bashku me iniciativën "Dita e drurit", vazhdimisht mbjellin fidane në oborret e shkollave dhe e gjelbërojnë mjedisin e tyre. Sipas organizatorëve të aksionit, përkushtimi i tillë dhe mbjellja e planifikuar ka efekte të shumëfishta dhe përfitime të gjëra jo vetëm për gjelbërim të oborreve të shkollave, por edhe për edukim dhe nxitje të ekovetëdijes tek të rinjtë.

Aksioni, krijues i të cilit është maestro Boris Trajanov, në vitin 2008 ngriti nismë me një grup të entuzistëve drejt mbjelljes së eko të ardhmes së re nxiti formim të Shoqatës qytetare "Dita e drurit - mbille të ardhmen tënde"!, e cila veçmë tetë vite, arriti që qytetarët e Maqedonisë t'i çojë në aksione të reja të suksesshme, thekson organizatori. (mia.mk)

MAQEDONI

## Tetovë, Dita Ndërkombëtare e HIV/SIDA-s, nënshkruhet memorandum-bashkëpunimi për preventivë



**Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sëmundjes së SIDË-s nënshkruhet memorandum-bashkëpunimi mes...**

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sëmundjes së SIDË-s nënshkruhet memorandum-bashkëpunimi mes Komunës së Tetovës, Shoqatës "Hops" dhe Qendrës për Zhvillim dhe Përparim të Jetës Publike në Tetovë.

Sipas përfaqësuesve të shoqatave, Maqedonia ka shkallë më të vogël të SIDË-s në rajon dhe me nënshkrimin e këtij memorandum Komuna e Tetovës obligohet në një farë forme

që të fillojë aktivitetet për preventivë ndaj kësaj sëmundje në nivel lokal.

***"Me këtë nënshkrim komuna në një farë forme obligohet që të fillojë aktivitete edhe atë prej sot në Tetovë këtë projekt e fillojmë në kuadër të projekteve për bashkëpunim ndërkufitar me Kosovën. Këtë e bëjmë se Maqedonia ka shkallë më të vogël të SIDË-s në rajon dhe prandaj aktivitetet e këtilla janë në këtë drejtim që të mbahet kjo shkallë e ulët"***- deklaroi drejtori ekzekutiv i "Hopps", Kristijan Janullovi.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Përfaqësuesi i komunës, Ahmet Qazimi, tha se Komuna e Tetovës i përkrah këto aktivitete që të vazhdohet shkalla e ulët e përhapjes së kësaj sëmundje.

**“Për mbajtjen e ulët të shkallës së SIDË-s duhet një qasje multidisiplinore dhe një qasje globale, dhe rëndësia është që ky projekt nënshkruhet në kuadër të IPA projekteve, që të ketë një qasje regjionale së bashku me qytetet tjera të përfshira në projekt dhe shpresojmë se me aktivitetet që do të ndërmarrë komuna do të ruhet numri i vogël i të prekurve nga SIDA”**- tha sektori për veprimtari publike në Komunën e Tetovës, Ahmed Qazimi.

Por në Tetovë megjithatë shënojnë rritje personat që evidentohen si punëtorë seksual, u shpreh Borisllav Pavlovski nga Qendra për Zhvillim dhe Përparim të Jetës Publike në Tetovë.

**“Nga viti në vit kemi rritje të personave që përdorin drogë, edhe atë personat që marrin shërbimet tona janë 350 persona të evidentuar si narkomanë dhe 84 punëtorë seksual. Ky program ka filluar nga viti 2014 dhe numri është rritur qind për qind tek punëtorët seksual”**- theksoi Borisllav Pavlovski nga Qendra për Zhvillim dhe Përparim të Jetës Publike në Tetovë.

HIV/AIDS është sëmundje që shkaktohet nga një virus për të cilin ende nuk është gjetur shërimi adekuat.

Mënyra më e mirë për parandalimin e kësaj sëmundje është edukimi shëndetësor. Në Maqedoni kjo sëmundje ka një shkallë më të ulët në rajon.

## Kumanovë, avancime kadrovike në sferën e shëndetësisë



**Një delegacion i BDI-së i përbërë nga drejtorë të enteve dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore, sot ka vizituar rajonin e Kumanovës dhe Likovës...**

Delegacioni fillimisht vizitoi Spitalin e Kumanovës, me ç'rast drejtori, Arif Latifi, mysafirët i njoftoi me të arriturat e këtij enti shëndetësor dhe pajisjet dhe aparaturat e reja në disa reparte spitalore.

Ai gjithashtu i njoftoi mysafirët edhe me ecuritë kadrovike në këtë spital, duke shënuar rritje të kuadrit shqiptar.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Më pas sekretari shtetëror i Ministrisë së Shëndetësisë, Nasuf Ipçe, tha se falë angazhimeve maksimale Spitali i Kumanovës sot ka rolin e spitalit rajonal, pasi që këtu trajtohen pacientë edhe nga komunat jashtë Kumanovës, si dhe nga Lugina e Preshevës, si Presheva, Bujanoci e Medvegja.

Në fund të kësaj vizite mysafirët bënë një gjest human me dhënien vullnetare të gjakut.

Delegacioni vizitoi edhe Stacionin Shëndetësor në Likovë, i cili prej sot me vendim të Qeverisë shndërrohet në Shtëpi Shëndeti.

Gjatë qëndrimit në Likovë u paralajmëruan edhe investime të tjera në sferën e shëndetësisë.

**PORTALB**  
dritare realiteti

## Sot është dita botërore e personave me aftësi të kufizuara



Dita botërore e personave me aftësi të kufizuara, 3 Dhjetori, synon ndërgjegjësimin e shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritimit të personave me aftësi të kufizuar.

Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat nevoja shëndetësore si edhe personat jo me aftësi të kufizuara, kanë nevojë për imunizim, depistim të kancerit, etj. Por ata gjithashtu janë më të prekshëm nga një sëmundje apo një problem shëndetësor, si për shkak të varfërisë, për shkak të përjashtimit social, gjithashtu edhe për shkak se ata mund të jenë më të prekshëm nga sëmundjet sekondare, të tilla si plagë apo infeksionet e traktit urinar.

Provat kanë treguar se njerëzit me aftësi të kufizuara përballen me pengesa në aksesin për shërbime shëndetësore dhe rehabilituese, për të cilat ata kanë nevojë për më shumë ambiente. Përçindja e personave me aftësisë të kufizuar është rritur ndër shkaqet e tjera, për shkak të plakjes së popullsisë dhe rritjes së sëmundjeve kronike.

Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë më pak akses në shërbimet shëndetësore dhe për këtë arsye ata përjetojnë nevoja të e paplotësuara të shërbimit të kujdesit shëndetësor.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Një grua siriane lind në spitalin e Kumanovës



Në spitalin e Kumanovës sot lindi një grua 30 vjeçare nga Siria, informoi reparti i gjinekologjisë dhe obstetrikës.

“Pacientja lindi një vajzë të shëndetshme. Nëna dhe e porsalindura janë në shëndet të mirë”, tha, mjekja Naile Osmani, gjinekologe e spitalit të Kumanovës, transmeton TetovaSot.

Ky është fëmija i gjashtë i sirianes nga qyteti i Aleppo, e cila tranziton për mes Maqedonisë me të shoqin dhe pesë fëmijët.

Mjekja Osmani tha se në spitalin e Kumanovës, pacientja është

sjellë nga ekipi i ndihmës së shpejtë nga punkti i pranimit në Tabanoc./TetovaSot